



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJYKATA SUPREME E KOSOVËS**  
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2022:261956

Datë: 17.07.2024

Numri i dokumentit: 05947047

**AC-I-23-0178**

**Në çështjen juridike të:**

**Paditësi/ankuesi**

**Q H** nga fshati P, Viti, i përfaqësuar nga avokat L M, Ferizaj.

**Kundër:**

**E paditura**

**N.SH "Agromorava"** (në likuidim), Prishtinë, e përfaqësuar nga **Agjencia Kosovare e Privatizimit**, rr. "Dritan Hoxha", nr.55, Lakrishte, Prishtinë.

Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJSK), i përbërë nga Mr. Sc. Sahit Sylejmani gjyqtar kryesues, Shkelzen Sylaj dhe Ilmi Bajrami gjyqtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit të parashtruar kundër Aktgjykimit të Shkallës së parë të DHPGJSK-së C-IV.-14-6581, të datës 09 mars 2023, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 17 korrik 2024, lëshon këtë:

**A K T G J Y K I M**

- 1. Ankesa e paditësit refuzohet si e pa bazuar.**
- 2. Vërtetohet Aktgjykimi i Shkallës së parë i DHPGJSK-së C-IV.-14-6581, i datës 09 mars 2023.**
- 3. Nuk caktohen taksa gjyqësore për procedurë ankimore.**

### **Rrethanat faktike dhe procedurale:**

Me 20 tetor 2014, paditësi ka dorëzuar në Dhomën e Posaçme, ankesë kundër Vendimit nr. GJI035-0180, të datës 03 tetor 2014, të Autoritetit të Likuidimit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit (më tej Autoriteti i Likuidimit ose shkurt AL), me të cilin ka kërkuar kompensimin për tre paga të papaguara, në shumë prej 600.00 Euro, nga NSH "Agromorava" (në likuidim), e cila ishte refuzuar si e pa vlefshme me arsyetimin se në bazë të nenit 608 të Ligjit për Punën e Bashkuar është parashkruar. Paditësi ka pohuar se NSH nuk i ka kryer obligimet ndaj punëtorëve, gjithashtu paditësi pohoi se ka qenë për kohë të pacaktuar punëtorë në NSH dhe marrëdhënia e tij e punës i është ndërprerë nga AKP-ja, për shkak të shitjes së aseteve të NSH-së. Ankuesi ankesës nuk ia ka bashkangjitur asnjë provë ne mbështetje të ankesës së tij.

Me 06 prill 2022, paditësi ka dorëzuar në gjykatë kopjen e vendimit të AL-së.

Me 25 maj 2022, e paditura parashtrori përgjigje në ankesë, në të cilën ka pohuar se AL-ja ka kryer një vlerësim të saktë të rrethanave faktike dhe se dispozitat ligjore janë zbatuar saktësisht. E paditura ka theksuar se pretendimet e paditësit janë të pabazuar dhe kërkesa për paga është parashkruara, pasi që në bazë të dispozitave ligjore, për të ndërprerë parashkrimin, kërkesa duhet të ishte paraqitur në gjykatë apo ndonjë autoritet kompetente, brenda tre viteve nga koha kur parashtruesi ka fituar të drejtën për të kërkuar dëmshpërblim për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës që nga qershori i vitit 2008. E paditura propozoi që ankesa të refuzohet si e pa bazuar dhe të vërtetohet vendimi i kundërshtuar.

Më 09 mars 2023, Shkalla e parë e DHPGJSK-së me Aktgjykimin C-IV-14-6581, e ka refuzuar si e pa bazuar ankesën e paditësit, dhe ka vërtetuar vendimin e AL, GJI035-0180 të datës 03 tetor 2014, si i drejtë dhe i bazuar në ligj, dhe nuk ka caktuar taksa gjyqësore për ankuesin.

Shkalla e parë ka arsyetuar se është parashkruar e drejta për të kërkuar në rrugë gjyqësore përmbushjen e detyrimit, andaj pretendimet e tjera të palëve nuk do të shqyrtohen. Shkalla e parë në arsyetim ka theksuar se Neni 37.4.4.1 i Shtojcës së Ligjit për AKP-në, parasheh: kërkesat që konsiderohen të jenë të pasafatshme sipas

afatit të kufizuar të përcaktuar me ligje të aplikueshme, si dhe kërkesat që nuk janë parashtruar në mënyrë të rregullt apo në kohë para gjykatës kompetente, refuzohen dhe nuk gëzojnë të drejtë për të marrë pjesë në disbursimet nga likuidimi; Tutje shkalla e parë ka shtuar se, për kohën kur pretendohet se është krijuar detyrimi, duhet të aplikohet parashkrimi i përgjithshëm për detyrimet civile. Këto rregulla gjinden në Ligjin mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD) nr. 690 të datës 30 mars 1978, të njëjtat rregulla gjinden edhe në Ligjin nr. 04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD) i cili ka hyrë në fuqi më 19 dhjetor 2012. Në pajtim me nenin 372, paragrafi 1 i LMD-së, parashkrimi i kërkesave periodike siç është paga, është tri (3) vjet; Ligji i ri ka mbajtur të njëjtin afat parashkrimi prej 3 vitesh (neni 353, paragrafi 1, i LMD-së). Po ashtu, Ligji i Punës nr. 03/L-212 i cili është në fuqi, nuk parasheh dispozitë të veçantë për parashkrimin në lidhje me pagesat e të ardhurave, por parasheh një afat të përgjithshëm prej 3 viteve të parashkrimit, në lidhje me kërkesat që lindin nga marrëdhënia e punës. Nga dispozitat e lartcekura, gjykata vlerëson se parashkrimi si institut i së drejtës civile në përgjithësi dhe në veçanti afati 3 vjeçar i parashkrimit për kërkesat monetare, është ruajtur në të gjitha ligjet që kanë qenë të aplikuara në atë kohë, por edhe në ligjet që tani janë në fuqi. Prandaj, shihet se parashkrimi për kompensim për ndërprerjen e kontratës së punës, në shumë prej 600.00 euro të kërkuar në këtë lëndë, ishte i rregulluar me LMD-në (1978), i cili ishte ligj ende në fuqi në atë kohë. Vetëm në dhjetor 2012 ligji i aplikueshëm ndryshoi, por edhe LMD tani në fuqi ka mbajtur të njëjtin afat parashkrimi prej 3 vjetësh. Në rastin konkret, e drejta për të kërkuar kompensimin e pretenduar për kompensimin për tre paga të pa paguara, është ligjërisht e vjetërsuar pas 3 viteve, pasi që NSH-ja nuk ka përmbushur detyrimin e saj ndaj parashtruesit të kërkesës brenda këtij afati dhe pasi që ankuesi nuk ka ofruar ndonjë dëshmi se ka paraqitur kërkesë në ndonjë procedurë gjyqësore, apo para ndonjë autoriteti kompetent brenda afatit 3 vjeçar, për të kërkuar borxhin e pretenduar në lidhje me kompensimin për tre paga të pa paguara dhe kështu për ta ndaluar rrjedhjen e afatit të parashkrimit. Sipas shkresave të lëndës, rrjedh se paditësi kërkesën për tre paga, e ka parashtruar pranë Autoritetit të Likuidimit më 12 gusht 2014, brenda afatit për parashtrimin e kërkesave pranë AL-së, por që në bazë të dispozitave ligjore të lartcekura, një kërkesë e tillë në atë kohë vetëm se ishte parashkruar.

Më 28 mars 2023, paditësi/ankuesi ka parashtruar ankesë të afatshme kundër aktgjykimit të Shkalla e I-rë C-IV-14-6581 të datës 09 mars 2023, duke propozuar që të aprovohet ankesa si e bazuar dhe të anulohet aktgjykimi i atakuar, dhe paditësit ti njehet e drejta në kompensim. Paditësi në ankesë ka pohuar se Autoriteti i Likuidimit ka vepruar pa u mbështetur në prova materiale juridike por ky autoritet shihet se ka vendosur në mënyrë blanko ju dorëzon vendimet e paditësve të cilat paditësit i konsiderojnë jo ligjore dhe jo profesional dhe fare pa u mbështetur në dispozita ligjore, por lidhur me këtë bëjnë vetëm një përshkrim të historikut të kësaj lende. Autoriteti i Likuidimit pa kurrfarë argumenti paraqet se kinse nuk janë përmbushur kushtet e një e një ankese sipas nenit 27.2.4, shtojca e ligjit 04/-L-033, e arsyeton se kinse e njëjta është e pa bazuar, por konsiderojmë se në mënyrë ligjore por e vërteta qëndron në atë se paditësi ka të drejtë për kompensimin e pagave të pa paguara sepse i njëjti në këtë ndërmarrje ka punuar për një periudhë të gjatë dhe e ka humbur shëndetin e tij, gjithashtu i plotësojnë kushtet ligjore se ka qenë punëtorë i kësaj ndërmarrje. Ankesës ja ka bashkangjitur autorizimin për përfaqësim.

Me 05 mars 2024, AKP-ja e dorëzoi në DHPGJS përgjigjen ndaj ankesës. Në këtë parashtrësë AKP-ja ka pohuar se argumentet e veta qartësisht i ka sqaruar në mbrojtjen në ankesë, andaj përsëritja e tyre do të ishte e pa dobishme për mbarëvajtjen e procedurës. AKP-ja ka kërkuar që të refuzohet ankesa si e pa bazuar dhe të vërtetohet Aktgjykimi i ankimuar si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

### **Arsyetimi ligjor:**

Ankesa e paditësit refuzohet si e pa bazuar.

Në bazë të nenit 69.1 të Ligjit nr. 06/L-086 mbi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (LDHP), Kolegji i Apelit vendosi të mos mbajë pjesën gojore të procedurës.

### **Merita e ankesës dhe vlerësimi i Kolegjit të Apelit**

Aktgjykimi i ankimuar i Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, është i saktë në rezultat dhe në arsyetim ligjor, andaj duhet të vërtetohet.

Kolegji i Apelit vëren se paditësi me datë 22 gusht 2014, e ka dorëzuar tek Autoriteti i Likuidimit të NSH.- N.B.I " Agromorava" (në likuidim), një kërkesë për kompensim për tre paga në shumën prej 600.00 euro, e cila është refuzuar si e pa vlefshme me arsyetim se kërkesa është parashkruar në bazë të nenit 608 të Ligjit për Punën e Bashkuar.

Kundër vendimit të AL GJI035-00180, paditësi kishte paraqitur ankesë në Shkallë të I-rë të DHPGJS për kompensim për tre paga në shumën prej 600.00 euro.

Shkalla e parë e DHPGJSK-së me Aktgjykimin C-IV-14-6581, të dt. 09 mars 2023, e ka refuzuar si e pa bazuar ankesën e paditësit, dhe ka vërtetuar vendimin e AL, GJI035-0180 të datës 03 tetor 2014, si i drejtë dhe i bazuar në Ligj.

Kolegji i Apelit pajtohet e me arsyetimin dhe vlerësimin e dhen nga Shkalla e I-rë se me vjetërsim/parashkrim, ligjërisht shuhet e drejta e kërimit të përmbushjes së detyrimit, ngase parashkrimi fillon të rrjedhë ditën e parë pas ditës kur kreditori të ketë pasur të drejtë të kërkojë përmbushjen e detyrimit, në qoftë se me ligj për raste të veçanta nuk është parashikuar diçka tjetër. Në rastin konkret, e drejta për të kërkuar kompensimin e pretenduar për kompensimin për tre paga të pa paguara, është ligjërisht e vjetërsuar pas 3 viteve, pasi që NSH-ja nuk ka përmbushur detyrimin e saj ndaj parashtruesit të kërkesës brenda këtij afati dhe pasi që paditësi nuk ka ofruar asnjë ndonjë dëshmi se ka paraqitur kërkesë në gjykatë, apo para ndonjë autoriteti kompetent brenda afatit 3 vjeçar, për të kërkuar borxhin e pretenduar në lidhje me kompensimin për ter paga të pa paguara dhe kështu për ta ndaluar rrjedhjen e afatit të parashkrimit.

Sipas shkresave të lëndës rrjedh se paditësi kërkesën për tre paga, e ka parashtruar pranë Autoritetit të Likuidimit më 12 gusht 2014, brenda afatit për parashtrimin e kërkesave pranë AL-së, por siç ka konstatuara edhe Shkalla e parë e DHPGJS në bazë të dispozitave ligjore, një kërkesë e tillë në atë kohë vetëm se ishte parashkruar. Kolegji i Apelit vlerëson se neni 608 i Ligjit për Punën e Bashkuar (Gazeta Zyrtare nr. 53/76), është i aplikueshëm sipas nenit 1 të Rregullores së UNMIK-ut 1999/24 në të cilin ishte mbështetur vendimi refuzues i AKP-së. Dispozita e nenit 608 parashikon se kërkesat monetare që rrjedhin nga marrëdhënia e punës parashkruhen për 3 vite.

Kolegji i Apelit vëren se paditësi, me parashtrimin e ankesës kundër vendimit të AL-së, nuk ka pohuar ndonjë fakt apo argument ligjor që do të bënin ndryshimin e rrethanave faktike, sa i përket parashkrimit të së drejtës për të kërkuar në rrugë gjyqësore kompensimin për tre paga dhe kështu për të ndikuar në ndryshimin e vendimit të ankimuar.

Kolegji i Apelit gjatë shqyrtimit të ankesës i ka marr në konsideratë pretendimet e paditësit lidhur me aktgjykimin e ankimuar dhe vlerëson se perëndimet e paditësit të paraqitura në ankesë kanë të bëjnë më tepër me vendimin e AL se sa të aktgjykimit të ankimuar. Andaj sipas vlerësimit të Kolegjit të Apelit aktgjykimi i shkallës së parë është i drejtë dhe i bazuar në Ligj. Kjo pasi që Shkalla e I-rë ka dhënë arsye konkrete për faktet vendimtare duke dhënë shpjegime dhe arsyet adekuate dhe të bazuar në dispozita ligjore që i referohen kësaj çështje juridike.

Kolegji i Apelit gjithashtu vëren se Shkalla parë, ka aplikuar saktë dispozitat ligjore, andaj pretendimet e paditësit në këtë aspekt janë të pabazuar.

Andaj nga se u tha më lartë, rezultati i dhënë me Aktgjykimin e ankimuar, nuk ka mundësi të ndryshohet, ashtu që ankesa e paditësit refuzohet si e pa bazuar, dhe vërtetohet Aktgjykimi i ankimuar si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Në bazë të nenit 9.10 të LDHP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

### **Taksa gjyqësore**

Paditësi/ankuesi, është i liruar nga pagesa e taksës në bazë të udhëzimit Administrativ nr.01/2017 për Unifikimin e Taksave Gjyqësore, pasi që vlera e kontestit është nën shumën prej 1000 euro.

Lëshuar nga Kolegji i Apelit i DHPGJS-së më 17 korrik 2024

Mr.sc. Sahit Sylejmani, Gjyqtar Kryesues

\_\_\_\_\_